



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Vushtrrisë
Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Zyra e Kryetarit të Komunës

Në bazë nenit 11 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil, pas autorizimit nga MAP/DASHC, Kryetari i Komunës, shpall:

K O N K U R S I B R E N D S H Ë M

Institucioni :Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria:Drejtoria për Buxhet e financa

Titulli i vendit të punës: Zyrtar i shpenzimeve (BF/240 / JP00029358);

Lloji i pozitës : I karrierës;

Kategoria funksionale/Grada: Niveli i koeficienteve (Koeficienti - 8);

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat;

Procedura e aplikimit: I brendshëm;

Orët e punës: 40 orë në javë;

Qëllimi i vendit të punës: Siguron që shpenzimet e buxhetit të bëhen në pajtim me rregullat dhe procedurat;

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

1. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre;
2. Siguron që shpenzimet e buxhetit të bëhen në pajtim me rregullat dhe procedurat financiare si dhe në pajtim me politikat e ministrisë;
3. Ofron të dhënat mbi shpenzimet buxhetore për planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm dhe ndihmon në përgatitjen e kërkesave fillestare buxhetore;
4. Përcakton dhe mbikëqyrë ofrimin e shërbimeve publike lokale, duke përfshirë furnizimin me ujë, rrjetin e ujësjellësit, të kanalizimit dhe përpunimin e ujërave të zeza;
5. Përgatit dhe kompletion dokumentacionin e nevojshëm për certifikimin e shpenzimeve buxhetore për të gjitha njësit organizative të ministrisë;
6. Sistemon dhe regjistron të gjitha shpenzimet buxhetore në sistem, analizon ecurinë e tyre dhe mban evidencën e tyre sipas strukturës së shpenzimeve;
7. Përgatit raporte financiare për shpenzimet dhe pagesat e kryera përmes sistemit dhe me para të gatshme sipas njësisë buxhetore të ministrisë;

8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur vetëm për nëpunës ekzistues (shërbyes civil) që i plotësojnë kushtet e nevojshme të përcaktuara me ligjet në fuqi si dhe kriteret e caktuara me këtë konkurs.

Kualifikimet e kërkuara

1. Diplome universitare, drejtimi ekonomik, financa, biznes apo të ngjashme, 2 vite përvojë profesionale;
2. Njohuri dhe përvojë në fushën e në fushën e buxhetit dhe financave;;

Shkathtësitë

1. Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
2. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
3. Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
4. Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit);

Afati i konkursit: 8 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën pritëse. Së bashku me aplikacion duhet të dorëzohen edhe këto dokumente në njërën prej gjuhëve zyrtare të komunës.

1. Ekstraktin e lindjes;
2. Kopjen e letërnjoftimit;
3. Diplomën e fakultetit të kryer;
4. Dëshminë për përvojën e punës;
5. Dëshminë se nuk është nën hetime.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku